



Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/ Nr. 6077
Data: 21.07.2022

PROCESVERBAL I RAPORTIT GJASHTËMUJOR TË PUNËS SË KRYETARIT

Procesverbali nga Raporti gjashtëmuor i punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit, të mbajtur me datën 30.06.2022, duke filluar nga ora 14:00 në sallën e koncerteve në Shtëpinë e Kulturës “Imri Curri” në Han të Elezit me gjithsej 32 pjesëmarrës, prej tyre 10 gra dhe 22 burra. Për prezentimin e Raportit, prezent ishte **Mehmet Ballazhi** (Kryetari i Komunës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës së Përgjithshme), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Nexhmedin Daci** (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Kimete Kuka-Hasallari** (Drejtoresh e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik) dhe **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport).

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës **z. Mehmet Ballazhi**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve që kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin publik mbi raportin gjashtëmuor të punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit dhe theksoi se ky raport do të prezentohej nga drejtorët dhe drejtoreshat e drejtorive përkatëse, ku secili do të prezentojë punën e bërë në drejtoritë e tyre, dhe një pjesë do ta prezentojë vet Kryetari apo për ndonjë plotësim do të përgjigjet edhe Nënkryetari i Komunës.

RENDI I PUNËS

1. Raporti gjashtëmuor i punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit

Mehmet Ballazhi: Kemi arritur 5 marrëveshje:

-Marrëveshje me MMPHI për projektin “Rregullimi i hapësirave publike dhe zgjerimi i rrugëve afër zonës kufitare” / Memorandum mirëkuptimi me organizatën Humanity First Kosova për familjet në nevojë me pako me produkte ushqimore për festën e Kurban Bajramit / Marrëveshje në kuadër të projektit TAKE në fushën e arsimit / Marrëveshje bashkëpunimi me skomunës Hani i Elezit dhe organizatës Qatar Charity Kosova me pako ushqimore gjatë muajit Ramazan dhe Kurban Bajram. / Bashkëpunim me kompaninë IPKO për vendosjen e sistemit të sofistikuar të ultrazërit.

Kemi hartuar 12 projekte të reja: Rregullimi i hapësirave publike dhe zgjerimi i rrugëve afër zonës kufitare Hani i Elezit / Rregullimi i parkut afër Lumit Lepenc / Projekti për vendosjen e paneleve solare në objektin e QKMF-së / Hartimi i fazës finale të projektit të qytetit Isa Berisha / Hartimi i

projektit për ndriçimin publik në zonën urbane dhe rurale në Han të Elezit në rrugën E të Përndjekurve / Hartimi i fazës finale të projektit tek AMF në fshatin Gorancë / Hartimi i projektit për shtegun e çiklistëve në magjistralen Hani i Elezit – Kaçanik / Hartimi i projektit për rregullimin e shtratit të Lumit Lepenc / Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Lagjen e Re dhe në fsh. Paldenicë, Pustenik, Seçishtë, Gorancë, Krivenik dhe Dimcë / Ndërtimi i shkallëve emergjente në shfmu Kështjella e Diturisë dhe shfmu Veli Ballazhi / Mbikalimi në afërsi të çerdhes së qytetit Ardhmëria dhe Mbikalimi në afërsi të fushës së futbollit dhe terminalit doganor. Është rritur numri i mjeteve për subvencione, gjithashtu edhe rritja e numrit të studentëve për bursa, kemi bërë ndryshimin mbi ndarjen e bursave ku janë përfshirë edhe studentët tanë nga universitete publike të shteteve fqinje. Kemi mbajtur për herë të parë Festivalin Folklorik Mbarëkombëtar i cili do të bëhet tradicional, kemi përkrahur vendosjen e shkronjave të UÇK-së, kemi marrë pjesë në Panairin ndërkombëtar. Ndërkaq për ujën e pishëm, jemi në fazën përfundimtare të funksionalizimit të fabrikës së ujit, dhe momentalisht jemi në fazën e rekrutimit të stafit që do të punojnë në fabrikë, pra janë procedura administrative, ku pas rekrutimit ata do të bëjnë trajnime, dhe siç e dini e kemi realizu pranimin teknik të fabrikës që me ia kalu në menaxhim Bifurkacionit. Shkurtimisht janë disa aktivitetet, por tani fjalën le ta marrin drejtorët/ët përkatës që të raportojnë mbi aktivitetet e drejtorive që udhëheqin. Dhe pas raportimit të çdo drejtorie, pjesëmarrësit mund të parashtrajnë pyetje, këshilla, sugjerime e rkitika për drejtorinë përkatëse.

Natyra Kalisi: Disa nga aktivitetet e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme shkurtimisht janë: deri me datën 15 janar kanë vazhduar të jepen dokumente të gjendje civile, gjatë pauzës dhe fundjavës, me rastin e ardhjes së bashkëatdhetarëve tanë, kemi vendosur onfografikat, si dhe kemi digjitalizuar njoftimet, kemi zhvilluar projektin e vendosjes së kamerave të sigurisë së qytetit dhe zonave përreth të cilat janë nën menaxhimin e Policisë së Kosovës, Kemi realizuar punëtori mbi kompetencat e komiteteve konsultative dhe këshillave lokal, mbi planin e veprimit të transparencës, mbi gjininë, paqen dhe sigurinë, si dhe aktivitete tjera të përditshme në DAP.

Hisni Luri: Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport ka zhvilluar këto aktivitete: digjitalizimi i shkollave, përkrahje për botimin e librave, ndarje e bursave për 40 studentë, vendosja e shkallëve emergjente në shkolla, përfitues të librave nga donacione dhe bashkëpunime, aktivitete kulturore të ndryshme, takime informuese me të rinjtë 16-24 vjeç për punë [raktike në bznese, ndarja e sibvencioneve për rini, sport, kulturë dhe OJQ tjera, aktivitete sportive për data të ndryshme, Java Kulturore, Turne ndërkombëtar në mundje, e të tjera.

Lindita Ballazhi: Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka tre sektorë: sektori për buxhet dhe financa, sektori për të hyrat dhe sektori i tatimit në pronë. Buxheti i vitit 2023 për Komunën Hani i Elezit sipas Ligjit të Buxhetit 08/L-193 është 3,349,715 €, ku gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 janë ekzekutuar 1,096,933.84 € e buxhetit apo 32.7%, Te sektori i tatimit në pronë kemi inkasuar 98,980.13 € apo 44.4% e planifikimit të të hyrave nga tatimi në pronë, si dhe të hyrat e deritanishme janë në shumë prej 163,114.99 € apo 29% e planifikimit total të të hyrave për vitin 2023. Kemi pasur edhe aktivitete, ndër ta: kemi përgatitur paqyrat financiare për vitin 2022 dhe i kemi dorëzuar pranë Ministrisë së Financave, kemi përgatitur raporte të ndryshme mujore dhe tremujore, kemi përgatitur Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026 dhe kemi organizuar 3 dëgjime puxhetore për KAB, si dhe kemi pranuar Raportin e auditimit dhe kemi hartuar planin e zbatimit të rekomandimeve të tyre.

Nexhmedin Daci: Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2023, kemi realizuar: fazën e parë të parkut Isa Berisha dhe kemi filluar punimet për fazën e dytë, është punuar në asfaltimin e rrugës Lagjja Ramukë – Paldenicë, është punuar në rrugën Lagjja Ballazhi – Pustenic, është punuar në ndërtimin e aneksit për këmbësor të ura e Seçishtës, është në procedura tenderimi ndërtimi i parkut rreth lumit Lepenc, kemi ndërtuar mure mbrojtëse në zonat urbane dhe rurale, gjithashtu është punuar edhe në projektin e ndërtimit (zgjerimi dhe rihapja) e rrugëve në zonat rurale. Gjithashtu janë edhe dy projekte të hartuara që presim t'i realizojmë, mbikalimin në afërsi të çerdhes Ardhmëria dhe mbikalimin në afërsi të fushës së futbollit dhe terminalit doganor.

Kimete Kuka Hasallari: Në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale kemi zhvilluar këto aktivitete: kemi pranuar mbi 600 pako ushqimore pas marrëveshjeve me organizata të ndryshme humanitare, si Humanity First, Qatar Charity dhe Mbretëria e Arabisë Saudite. Kemi bërë riparime infrastrukturore në nyjet sanitare dhe rrjetin e rrymës në QKMF. Në bashkëpunim me Caritas kemi shtuar numrin e stafit dhe në bashkëpunim me Sharrcem kemi angazhuar stomatolog dhe kemi funksionalizuar sektorin e stomatologjisë. Kemi zhvilluar aktivitete të ndryshme edukative shëndetësore, kemi realizuar aktivitetet e dhurimit të gjakut me gjithsej 133 dhurues këtë vit, dhe kemi realizuar fazën e parë të dezinfektimit të hapësirave publike.

Majlinda Kaloshi: Në kuadër të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik kemi hartuar dokumente të ndryshme, duke përfshirë Dokumentin informativ Profili Ekonomik i Hani të Elezit, kemi qenë pjesë grupit për hartimin e projektit Parku Memorial Bllaca 99, pjesë e hartimit të projektit Parku në afërsi të lumit Lepenc, si dhe kemi përgatitur fletushka dhe broshura promovuese të vendit. Kemi lidhur bashkëpunime të ndryshme, si: me amb. Japoneze për plotësimin e projektit Rregullimi i aneksit për këmbësor në urën e Seçishtës, me IPA Fondet në lidhje me A smart system for Early Floods Detection and Wave Monitoring in the River Basin, bashkëpunim me Agjencionin për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale për projektin Eksodi i Bllacës 99, si dhe kemi angazhuar një konsulent të jashtëm pranë DZHE-së për projektet nga Agjencionin për Zhvillim Rajonal Lindje. Nga taksat për ushtrim të veprimtarisë për periudhën janar-maj 2023 kemi inkasuar shumën prej 10,056.84 më shumë se sa vitin e kaluar për të njëjtën kohë.

Abdurraman Bushi: Disa nga aktivitetet e Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural janë: kemi përgatitur projektet për aplikim në OJQ TIKa, Islamic Relief Kosova dhe ICO për mbështetje të fermerëve të komunës tonë me impute bujqësore, kemi pranuar aplikacionet nga fermerët për subvencionet direkte nga Ministria ku kanë aplikuar 101 fermerë. Kemi formuar komisione për shyrtrimin e kërkesave për prerje të drunjëve në pyjet private, për regjistrimin e dëmit [pyjor për ndërrim terreni të rojeve, për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore nga era, si dhe për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Disa aktivitete tjera: kemi përgatitur raporte për MZBPZHR mbi raportin e të mbjelave pranverore dhe ujitjes. Takime me OJQ LAB, TIKa, IRK, ICO, ICK, Mëshjtjerra, etj. Kemi bërë përcaktimin e vendit dhe monitorimin e groposjes së gjedhit të infektuar nga brucelozja në fsh. Krivenik, kemi përgatitur Planin Zhvillimor të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për Komunën Hani i Elezit, si dhe kemi përgatitur lëndët, fletë[araqitjet e gjukatës, ku gjithsej kanë qenë 79 fletëparaqitje.

Mehmet Ballazhi: Nëse dikush ka ndonjë pyetje, kritikë apo sugjerim, mund ta merrni fjalën.

Basri Maliqi: Meqenëse në Han të Elezit kemi shumë pak tokë pjellore, e do të ishte mirë me hulumtu për donacione potencialë edhe me i ndihmu fermerët sidomos atyre që mbjellin grurë, e me i ndihmu ose me farë ose me pleh ose artikuj tjerë, do të ishte si stimulim, sidomos për zonën e Krevenikut ku prodhon rendimentin më të mirë në Kosovë të grurit.

Abdurraman Bushi: Nga DBPZHR kemi ndarë 4,000 € për subvencionim të mbjelljes së grurit në vjeshtë, ku e kemi llogaritur 20 ha nga 200 € ndërsa për hulumtime të tokave bujqësore jemi në bisedime me Fakultetin e Bujqësisë.

Fitim Thaçi: Më intereson të di a është i përfshim në ndonjë projekt pjesa të rruga Martirët Bushi, prej fundit të shkallëve dmth deri shfmu Ilaz Thaçi, me pas qenë mundësi që me u zgjeru pak ajo pjesa, si dhe me u vendos një trotuar, shkak i kalimit të madh të nxënësve nga ajo pjesë.

Nexhmedin Daci: Ne jemi tu e hartu projektin për atë pjesë të rrugës nga shkallët deri te trafo dhe ka me u zgjeru ku ka me hy pak tek shkolla, ndërsa nga trafo e andej nuk mundemi me ndërhy, dhe ky projekt besoj për 1-2 muaj do të fillojë.


Ahmet Krasniqi: Nji shqetësim që e kam ngrit edhe ma herët, edhe vitin e kalum, vendosjen e koritave në proje të prroi i Lakut, ka gjatësi 8 metra, dhe nuk e kam pa që është në projekt.

Mehmet Ballazhi: Sa i përket prrojeve, e dini që e kemi pas hartu një projekt dhe kemi apliku në IPA Fonde, ku e kemi pas kalu fazën e parë, por u patën anulë aplikimet dhe do të tentojmë edhe vitin e ardhshëm.

Lumni Berisha: Një nga problematikat që kemi në QKMF është mungesa e stafit shëndetësor, edhe pse kemi pas shtim të stafit përmes donatorëve të ndryshme, megjithëse ia dalim të kryejmë punën tonë.

Mehmet Ballazhi: A ka edhe dikush diçka me shtu? Nëse nuk e ka, e konsideroj të mbyllur takimin e sotëm.

Takimi përfundoi në ora 14:55

Procesmbajtësja

Liridona Ballazhi





Republika e Kosovës / Republic of Kosova
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



Lista e pjesëmarrësve – Takimi i parë me qytetarë lidhur me Raportin e
gjyeshëmujorit të parë 2023 i Kryetarit të Komunës

Data: 30.06.2023

Ora: 14:00

Vendi: Shtëpia e Kulturës "Imri Curri" – Hani i Elezit

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Pozita/Institucioni/Vendi	Telefoni	Nënshkrimi
1	Ahmet Krasniqi	Drejtor SHFMU K. Diturisë	044-146-518	
2	Abdullavmurat Basha	Drejtor, Bujqësi	045-928-000	
3	Jehmir Shkreta	Dokteri i stomatologjisë	049-345-157	
4	Lumir Berisha	Drejtori QKMF	044-186-125	
5	Ergina Kuka	Praktikante QKMF	044-323-970	
6	Sady Shiti	Praktikante QKMF	045-696-690	
7	Xhelal Daut	st. administrativ	044-142-719	
8	Amir Buxhi	Drejtori i DRS	044/280-368	
9	Vitor Hoxhallari	K. V. L	044/1819-352	
10	Selman Curri	ANS, H-E		
11	Isuf Shyti	Mirëmbajtës i obj.	044 867 738	
12	Sean Qeremir	Uj - HANA	044/227/54	
13	Aziz Haxhi	Uj - HANA	044/436001	
14	Vlora Rana	Z. HANA	044/845/080	
15	Metë Bardha	Z. Personelit	044/648-132	
16	Basri Mahçi	Aktivizistat	044-287 647	
17	Kujtim Dugani	DJAPG	044 280 619	
18	Fitim Thaci	Mësimdhënësi	044-721731	
19	Ziber Xhoni	Drejtor Durrës	044 354 001	
20	Shkëlqim Durrës		043 892 - 918	
21	NEZIM CURRI		045 550 787	
22	Alban Laci	Z. BIRIKTES	044-365-051	
23	Muhareza Rasti	Z. K. Rini dhe G. Rini	044 280 616	
24	Ljiljeta Doci	Z. Kabinçka e Kryetarit	045 676-077	
25	Mimote Kuka	DJAPG	049-691-580	
26	Shoni Curri	QYTETAR	049/928-546	
27	LINDITA BALLAZHI	DBF	049 922-400	
28	Katrina Halisi	DAP	045815-639	
29	MARJANDA KALOSTI	DZHE	049934 659	
30	HISMI LIRI	DKARS	044/909-734	
31	Nexmedin Duri	DUKAM	044237 995	
32	LIRIDONA BALLAZHI	Kab. i Kryetarit	044/862-571	